



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:010596
Datë: 18.04.2024
Numri i dokumentit: 05587382

C-IV-14-7279

Parashtruesja e kërkesës

M Gj nga Prizreni, përfaqësuar avokati **B I**, Prishtinë

kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) (NSH “Komuna” në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, 18 prill 2024 lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Kërkesa për rishikim të Aktvendimit të Autoritetit të Likuidimit aprovet si pjesërisht e bazuar.**
- 2. Shfuqizohet Aktvendimi i Autoritetit të likuidimit PRZ035-0180/51 datë 30 shtator 2013.**
- 3. Obligohet Autoriteti i Likuidimit i AKP që ankueses, M Gj në emër të kompensimit të pagave të papaguara, ti paguhet shuma prej 2,570.12 Euro, dhe në emër të taksave gjyqësore shumë prej 20.00 Euro.**
- 4. Pjesa tjetër e mbetur në shumë prej 197.88 Euro refuzohet si e pabazuar.**
- 5. Obligohet Autoriteti i Likuidimit që përfaqësuesit të ankuesit, avokat B I në emër të përpilimit të kërkesës për rishikim – ankesës si dhe përgjigjes në përgjigje të ja paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 208.00 Euro gjersa pjesa tjetër e mbetur prej 104.00 Euro në emër të kërkesës kreditore dhe shqyrtimit të shkresave refuzohet.**
- 6. Nuk caktohen shpenzime tjera gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Fillimisht, me 30 tetor 2013, pranë DHPGJS është parashtruar një kërkesë grupore e 92 punëtorëve të NSH, me të cilën kanë kërkuar rishikimin e Vendimeve të AL të secilit ankues individualisht.

Lënda pranë DHPGJS evidentohet si lënda C-IV-13-2716.

Me urdhrin e gjyqtarit, datë 2 korrik 2014, lënda si më lartë, ndahet individualisht për çdo ankues.

Përfaqësuesi i ankueses me 27 nëntor 2014, parashtron tani një kërkesë individuale për ankuesen, M Gj

Ankuesja kërkon rishikimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRZ035-0180/51 datë 30 shtator 2013 (në tekstin e më tutjeshëm Vendimi) me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin të pagave të papaguara, për periudhën nga muaji janar 2004 e gjer dhjetor 2005, në shumë prej 2,768.00 (dy shatë gjashtë tetë) Euro, ndaj NSH “Komuna” (në likuidim).

Ankuesja kundërshtoj Vendimin e AL për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimi jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të dispozitave materiale.

Ankuesja pohoi se pranë NSH ka punuar nga data 22 nëntor 1972 gjer kur me anë të njoftimit së Agjencisë, datë 27 mars 2007, i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Ankuesja pohon se shkeljet e dispozitave procedurale konsistojnë në faktin e zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 me Udhëzimin e saj administrativ, dispozitave ligjore të Ligjit për procedurën administrative si dhe dispozitave Ligjore të Ligjit për procedurën kontestimore.

Ankuesja pohon se pagat nuk i janë paguar dhe atë nga muaji janar 2004 e gjer dhjetor 2005.

Ankuesja në vijim pohon se AL gabimisht ka zbatuar dispozitat ligjore të Ligjit për punën e bashkuar duke konsideruar se ky ligj nuk është ligj i zbatueshëm në Kosovë nga viti 1989.

Ligji i aplikueshëm, sipas ankueses, do të duhej të ishte Ligji mbi ndërmarrjet (nr. 77/88 gazeta zyrtare e RSFJ). Se ky ligj është i aplikueshëm tregon edhe fakti se ky aplikim parashihet sipas Rregullores mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit- AKM – nr. 2002/12 me ndryshime dhe plotësime.

Ankuesja përfundimisht pohon se e drejta e ankueses mbi pagat parashihet edhe Ligjin mbi marrëdhëniet e punës të Kosovës (nr. 12 dhe nr. 24 gazetare zyrtare të KSAK).

Nga gjitha arsyet propozon që kërkesa e saj mbi pagat e papaguara, në shumën e kërkuar, të aprovet.

Kërkesës për rishikim – ankesës i janë bashkangjitur:

- Kopja e Autorizimit për përfaqësuesin,
- Kopja e Njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, drejtuar ankueses, njoftim ky lëshuar nga AKP (në tekstin në vijim NJOFTIMI),

- Kopja e Njoftimit mbi iniciimin e procedurës së likuidimit të NSH, dhe
- Kopja e Vendimit të AL.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 13 shkurt 2024 parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. Sipas AKP AL me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e ankueses ka vendosur në mënyrë të drejtë. AKP tutje pohon se ankuesja nuk ka ofruar argumente ligjore, në favor të ankesës së saj, ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP përfundimisht pohon se kërkesa kreditore e ankueses konsiderohet e pabazuar respektivisht parashkruar në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për AKP respektivisht Ligjit për punën e bashkuar - LPB. AKP i referohet vendimeve të DHPGJS, Nga gjitha arsyet propozoj që ankesa e ankueses të refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigjes i është bashkangjitur

- Kopja e Vendimit të AL.

Duke ju përgjigjur urdhrin të gjykatës, përfaqësuesi i ankueses me 22 shkurt 2024, parashtroj përgjigjen ndaj përgjigjes së AKP.

Ankuesja kundërshtoj në tërësi pohimet e AKP si të pabazuara. Ankuesja konsideron se në rastin konkret është Ligji për AKP që duhet të aplikohet si “lex specialis. Në rastin konkret, kërkesa e ankueses për paga të papaguara nuk do të duhej të konsiderohej e parashkruar sepse NJOFTIMI ka ndërprerë parashkrimin dhe se lidhur me këtë fakt tani më ekziston edhe jurisipodencia e DHPGJS. Ankuesja i referohet vendimeve të DHPGJS. Përfundimisht u kërkua kompensimi i shpenzimeve gjyqësore në shumë totale prej 312 Euro, dhe atë lidhur me kërkesën e parashtruar pranë AL shumë prej 52 Euro, shqyrtimin e shkresave të lëndës shumë prej 52 Euro, hartimin e kërkesës për rishikim shumë prej 104 Euro dhe kundërshtimit të përgjigjes së AKP shumë prej 104 Euro. U kërkuan edhe kompensimi i taksës gjyqësore në shumë prej 21 euro.

Përgjigjes i janë bashkangjitur:

- Kopja e NJOFTIMIT,
- Kopja e librezës së punës,
- Kopja e listës së pagave të papaguara të punëtorëve të NSH për vitet 2004 gjer 2007. Sipas kësaj liste shihet se ankuesja, sipas numrit rendor 51, figuron në këtë listë (në tekstin në vijim LISTA E PAGAVE).

Arsyetimi ligjor:

Kërkesa për rishikim aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata konsideron se lidhur kompensimin, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 parashihet kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person të sjella nga

punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në.

Tutje sipas nenit 40 paragrafi 1.7, të shtojcës së Ligjit për AKP, parashihet përmbusha e kërkesave siç janë: *“kërkesat e pasiguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë”*.

Nga dispozita e lartcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën dëmshpërblim nëse:

- a. Pagat e punonjësit, në këtë rast ankueses, nuk janë paguar, duke u kufizuar në tri paga bruto por edhe përshirë edhe kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë,
- b. Marrëdhënia e punës i është ndërprerë si rezultat i Vendimit të AKP, dhe
- c. Ndonjë veprimi tjetër nga ana e Agjencisë, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Në këtë rast ankuesja ka arritur që të dëshmojë se ka qenë punëtore e NSH në kohën e privatizimit të saj dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit/veprimit të Agjencisë.

LISTA E PAGAVE dhe NJOFTIMI të parashtruara nga ankuesja, argumentojnë faktin se:

- a. ankueses i janë mbetur pagat e papaguara, dhe
- b. se e njëjta ka qenë punëtore aktive e NSH-së gjër me datën e privatizimit, respektivisht 27 mars 2007, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja.

AKP, asnjëherë, nuk e ka kundërshtuar shumën e kërkuar nga ana e ankueses, respektivisht nuk e ka argumentuar të kundërtën me çka ankueses do ti mohohet e drejta në kompensimin e pagave. AKP faktet nuk i kontestuar (*positive litis contnestation*) e për më tepër provat e parashtruara, siç u cekën më lart, kanë dëshmuar, vërtetësinë e pohimeve të palës së kundërt, në këtë rast ankueses. Kjo shihet nga fakti se AKP, edhe si një nga arsyet mbi refuzimin e kërkesës e potencon çështjen e parashkrimit.

Gjykata me rastin e aprovimit të shumës, është bazuar në LISTËN E PAGAVE nga e cila shihet shuma e mbetur e papaguar, për ankuesen, për periudhën janar 2004 e gjer dhjetor 2005, në shumë totale prej 2,570.12 (dy pesë shtatë zero një dy) Euro, ashtu siç qëndron edhe në pikën 3 të dispozitivit të aktgjykimit.

Andaj nga të gjitha arsyet e dhëna si më lartë gjykata konsideron se ankuesja ka arritur që të dëshmojë të drejtën në kompensim, në shumën e cekur si më lartë, sipas nenit 40 paragrafi 1.7, të Shtojcës së Ligjit për AKP.

Pjesa e mbetur në shumë prej 197.88 (një nëntë shtatë tetë tetë) Euro, nuk është dëshmuar ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS. LISTA E PAGAVE, e parashtruar nga ankuesja, tregon shumën e aprovuar sipas këtij aktgjykimi e jo edhe shumën e kërkuar. Andaj gjykata vendosi si në pikën 4 të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ankuesja, si me kërkesën e saj për rishikim-ankesë e po ashtu edhe me përgjigjen ndaj përgjigjes së AKP, nuk ka kërkuar kamatën ligjore.

Çështja e parashkrimit të kërkesave të ankueses

LIBREZA E PUNËS dhe NJOFTIMI argumentojnë faktin se ankuesja ishte punëtore aktive e NSH-së gjer me datën e privatizimit të saj, 27 mars 2007.

AL me anë të vendimit të saj si dhe AKP në përgjigje ndaj rastit të ngjashëm, lidhur me parashkrimin i referohet nenit 608 pika 1 të Ligjit për punën e bashkuar - LPB (gazeta zyrtare e RSFJ 53/76).

Këtë konkludim të AKP-së gjykata e konsideron si aplikim të gabuar të dispozitave ligjore, nga arsytet si në vijim.

Tutje lidhur me parashkrimin e kërkesave, sipas nenit 608 në paragrafin 2 të LPB thuhet:

“Në parashkrimin e kërkesave sipas pikes 1 të këtij neni në mënyrë të ngjashme aplikohen rregullat e përgjithshme mbi parashkrimin e kërkesave, në rastet kur ato kërkesa parashkruhen për tri vite”.

Më tutje sipas nenit 370, të po të njëjtit ligj, thuhet:

“ Rregullat për parashkrimin nuk zbatohen në rastet kur me ligj janë caktuar afatet brenda të cilave duhet të paraqitet padia ose të kryhet një veprim, nën kërcënim të humbjes së të drejtave”.

Dispozitat e lartë cekura të LMD, ishin në aplikim në kohën e marrjes së njoftimit.

Dispozita identike parashihen edhe sipas Ligjit të Kosovës (nr. 04/L-077) për marrëdhëniet e detyrimeve (neni 347 dhe 351), dispozita ligjore këto, në aplikim në kohën e marrjes së Vendimit të AKP.

Rregullat për parashkrimin në rastin konkret nuk mund të zbatohen sepse veprimi i vetëm i ankueses, në rastin konkret, ishte kërkesa drejtuar pranë Komitetit të Likuidimit e që afatet dhe procedura e likuidimit rregullohet me ligj të veçantë e në këtë rast me Ligjin për AKP (shtojca e ligjit) dhe se përfundimisht afatet rrjedhin nga momenti i njoftimit së procedurës së likuidimit.

Së dyti, duke u bazuar në nenin 370 të LMD Jugosllav respektivisht nenit 351 të LMD të Kosovës, Ligji për AKP – shtojca e saj, rregullon procedurën e likuidimit të një NSH si procedurën dhe mënyrën e likuidimit si dhe përmbushjen e obligimeve ndaj kreditorëve eventual, afatet e parashtrimit të kërkesave etj.

Si ilustrim, të lartëcekurës, shih nenin 10 të Shtojcës së Ligjit për AKP ku parashihet se çdo procedurë eventuale, gjyqësore, administrative etj, ndaj një NSH e cila tani më ka hyrë në proces të Likuidimit, duhet të ndërpritet.

Përfundimisht procedura e likuidimit të një NSH, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, është e vetmja mënyrë proceduralo - ligjore lidhur me përmbushjen e obligimeve kreditore, si ndaj punëtorëve e po ashtu edhe ndaj kreditorëve tjerë potencial (lex specialis).

Asnjë punëtor/e apo kreditor potencial, nuk mund ti realizoj të drejtat e tyre kreditore ndaj një NSH, pa hapjen e procedurës së likuidimit nga ana e AKP, dhe referenca si ajo se parashtruesi nuk ka inicuar rast ligjor, konsiderohet i papranueshëm.

Në bazë të nenit 54 paragrafi 1 nenit 74 paragrafi 4 të Ligjit për DHPGJS u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Shpenzimet gjyqësore

Ankuesja ka paguar taksat gjyqësore.

Bazuar në nenin 6.2 lidhur me nenin 6.1 të Rregullores për tarifën e avokatëve, datë 18 mars 2017, vendosi si në pikën 4 (katër) të dispozitivit të këtij Aktgjykimi. Shuma e mbetur prej 104.00 (një zero katër) Euro, për përfaqësim pranë AL refuzohet me arsyetim se përfaqësuesit në rastin konkret mund ti gjykohen vetëm se shpenzimet për përfaqësim pranë gjykatës e jo edhe pranë AL. Lidhur me shikimin e shkresave përfaqësuesi nuk ka bërë një veprim të tillë.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar